



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:155554

Datë: 09.01.2025

Numri i dokumentit: 06689237

E.nr.246/2023

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Riza Livoreka dhe sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorit L.Sh nga Hani i Elezit, të cilën e përfaqëson avokatja F.H, nga Ferizaj, rruga e ..., pnr , kundër debitorit Komuna e Hanit të Elezit -Drejtoria Komunale e Arsimit, rruga “Nuri Bushi” nr.2, për pagesën e diferencën në pagën bazë, më datë 09/01.2025, mori dhe bëri përpilimin e këtij:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.246/2023, të kreditores L.Sh nga Hani i Elezit, kundër debitorit Komuna Hani i Elezit -Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit-pagimin e pagave jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës përbarimore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.246/2023, të datës 18.07.2023, e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditores L.Shnga Hani i Elezit, kundër debitorit Komuna e Hanit të Elezit -Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e diferencës në pagën bazë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Pajtitimit Gjyqësor 2021:178925, i datës 19.05.223.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 04.10.2024, e ka urdhëruar Ministrin e

Financave, Punës dhe Transferave -Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,179,08€, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

E autorizuar e kreditorit , e ka njoftuar gjykatën se është bërë pagesa e shumës së kërkuar me propozim dhe ka kërkuar që të përfundohet procedura përmbare. Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66 par 4, të LPP-së. Me këtë dispozitë është paraparë se pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbare, e në rastin konkret debitori e ka përmbush detyrimin gjykata e përfundoi procedurën përmbare në këtë çështje përmbare.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

E.nr.246/2023, më datë 09/01/2025

GJYQTARI

Riza Livoreka

Dërguar me datën 09/01/2025

Kreditorit 1x1

Debitorit 1x1